



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



**KOMUNA E GJAKOVËS**

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**

01 Nr. 011/a-26894 /2022

**Datë: 24.11.2022**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.11.2022 pas diskutimit në pikën e 3 të rendit të ditës : Propozim Vendim nga Kryetari të Komunës për Shfuqizimin e vendimit nr.01-011-14192/2021 për shpalljen e Interesit Publik në Pjesën e Parcelës në Degëzimin e Rrugës “ Nëna Terezë “ me qëllim të Shpronësimit për Realizimin e Projektit për Ndërtimin e rrugës , e miratoi këtë:

**V E N D I M**

**Për**

**Shfuqizimin**

**e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.01-011-14192/2021 i datës 31.05.2021 .**

1. Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës nr.01-011-14192/2021 i datës 31.05.2021 për Shpalljen e Interesit Publik në pjesët e Parcelave : 5797-0, 1032-1, 1032-3, 1032-4, dhe 1032-5, në Degëzimin e Rrugës “ Nëna Terezë “ me qëllim të Shpronësimit për Realizimin e Projektit për ndërtimin e rrugës .
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
3. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
  - Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
  - Drejtorisë për Shërbime Publike .
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Arbëneshë Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës